ALBANIAN BESA CAPITAL

**Tirane me, 18 Qershor 2021**

**Emertimi dhe Forma Ligjore:** **Fondacioni Albanian BESA Capital**

**Aktiviteti:** **Veprimtari te Organizatave Jo- Fitimprurese**

**NIPT-i:** **K 92431451 E**

**Adresa:** **Rr. "Dritan Hoxha", Laprake, Tirane**

**Tel. ++355 4 2 253 841/842**
**www.abcfoundation.info**
**info@abcfoundation.info**

# RAPORTI I PERFORMANCES – VITI 2020

**PERMBAJTJA** **FAQE**


- **Informacion i pergjithshem** 3
- **Objektivat dhe aktivitetet** 4
- **Arritjet dhe performanca** 5
- **Raportimi financiar** 9
- **Struktura, drejtimi dhe mbikqyrja** 14
- **Synimet per te ardhmen** 16


Rr. "Dritan Hoxha", Laprakë, Tirana, Albania
Tel/Fax: ++ 355 4 2 253 841/842, www.abcfoundation.info ; info@abcfoundation.info

## ➢ INFORMACION I PERGJITHSHEM

Fondacioni Albanian Besa Capital, eshte nje organizate jofitimprurese, rregjistruar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me vendimin Nr. 287, date 19/09/2008 dhe pajisur nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve me Certifikaten e Rregjistrimit me numer identifikimi NIPT: K 92431451 E, me adrese te veprimtarise: Rr. "Dritan Hoxha", Laprake, Tirane.
Drejtimi I Fondacionit ABC behet nga Bordi Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv si perfaqesues ligjor I Fondacionit me te tretet.
Fondacioni "ALBANIAN BESA CAPITAL" eshte nje organizate jofitimprurese pa anetaresi, e pavarur jo qeveritare, jo politike, e krijuar me vullnet te lire nga themeluesit, te cilet nuk ndjekin qellime fitimi dhe eshte i hapur per te gjithe ata qe punojne per realizimin e qellimeve te tij. Fondacioni ABC ushtron aktivitetin si fondacion konform Statutit, Aktit te Themelimit dhe Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

**Qellimi I krijimit te Fondacionit Albanian Besa Capital eshte:**

- Dhenia e ndihmes ne forme grantesh grupeve ne nevoje, me qellim angazhimin dhe permiresimin e jetes social ekonomike te ketyre grupeve.
- Nxitja dhe zhvillimi I veprimtarive ekonomike te subjekteve juridike dhe fizike, te cilet operojne ne fushen e biznesit te vogel dhe te mesem ne Shqiperi, duke dhene mbeshtetje financiare per krijimin e vendeve te reja te punes dhe vetepunesimin, nxitjen e sipermarrjes private, zhvillimin, promovimin dhe zgjerimin e aktivitetit te ketyre entiteteve, duke I nxitur ato per iniciativa te sipermarrjes private me qellim zhvillimin ekonomik dhe social ne vend.
- Mbeshtetja e shoqerise civile dhe grupeve te interesit me qellim permiresimin e klimes se biznesit ne Shqiperi.

**Per realizimin e qellimeve te mesiperme, objekte te veprimtarise se Fondacionit ABC, jane:**

1. Realizimi i seminareve dhe trajnimeve me subjektet private qe operojne ne fushen e biznesit te vogel dhe te mesem;
2. Publikimi i materialeve te ndryshme me permbajtje profesionale ne ndihme te subjekteve qe ushtrojne veprimtari ekonomike si biznes i vogel apo i mesem;
3. Sigurimin e kryerjes se kualifikimeve dhe te asistences teknike per personat fizike dhe juridike, si dhe dhenia e asistences teknike personave fizike dhe juridike me praktika te mire-administrimit te biznesit;
4. Kryerja e studimeve dhe vezhgimeve ne sektorin e veprimtarise se personave fizike dhe juridike;
5. Kryerja e studimeve, vezhgimeve dhe kerkimeve per sektore apo dege te veçanta ne sherbim per te nxitur sipermarrjen private ne Shqiperi.
6. Realizimi i politikave rekomanduese qe ndihmojne veprimtarine e personave fizike dhe juridike;
7. Dhenia e ndihmes per realizimin e marredhenieve publike dhe publiciteti me personat fizike dhe juridike;
8. Zhvillimi aktiviteteve ekonomike dhe jo ekonomike qe mbeshtesin qellimet kryesore te Fondacionit;

9. Pjesemarrja ne Institutet Financiare dhe ne Shoqeri Tregtare me objekt veprimtarie te ndryshme si dhe te çdo lloji dhe forme organizimi.
10. Dhenia e ndihmes, kryesisht ne forme grantesh per grupet ne nevoje nepermjet mbeshtetjes dhe angazhimit te tyre ne veprimtari per permiresimin e jetes social-ekonomike. Mbeshtetje dhe ndihme ne ngritjen e sipermarrjeve te vogla dhe familjare ne fusha te ndryshme te ekonomise.
11. Zhvillimi i aktiviteteve dhe veprimtarive per nxitjen e sipermarrjes per te rinjte e sapodiplomuar dhe te papune, si grup ne nevoje, me qellim integrimin e tyre ne jeten social-ekonomike.
12. Mbeshtetje financiare dhe me investime per sistemin arsimor, me qellim permiresimin e kushteve dhe te infrastruktures, ne favor te perfituesve te drejtperdrejte.
13. Zhvillimi i aktiviteteve per permiresimin e mjedisit dhe zhvillimit te turizmit duke forcuar kapacitetet turistike familjare dhe lokale, duke i dhene perparesi zonave potenciale, por ne veshtiresi ekonomike.
14. Nxitjen dhe zhvillimin e agroturizmit, mbeshtetjen financiare te subjekteve tregtare qe kane te bejne me prodhimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqesore, blegtorale dhe ngritjen e industrise agroperpunuese.

## ➢ OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Gjate vitit 2020 sikurse edhe ne vitet e meparshme, Fondacioni ABC ne fokus te tij ka patur realizimin e objektivave dhe aktiviteteve ne permbushje te qellimit te tij ne mbeshtetjen financiare nepemjet grantdhenies, duke sjelle nje impakt pozitiv ne jeten ekonomike, sociale dhe kulturore ne Shqiperi.

✓ **Ne mbeshtetje te grupeve ne nevoje** ne kushtet e fushates humanitare ne ndihme te familjeve ne nevoje per shkak te situates se krijuar nga pandemia COVID-19", nepermjet ofrimit te produkteve te ndryshme ushqimore.

✓ **Ne mbeshtetje te biznesit per zhvillimin ekonomik dhe social ne Shqiperi**

Gjate vitit 2020 jane mbeshtetur me fonde grant projekte me objekt rritjen e kapaciteteve te biznesit dhe grupeve te interesit nepermjet realizimit te studimeve, trajnimeve dhe seminareve per ato subjekte qe operojne ne fushen e biznesit te vogel dhe te mesem ne Shqiperi, nepermjet:

- Mbeshtetjes se te rinjve permes projektit INTERNSHIP, me qellim aftesimin profesional dhe pershtatjen e tyre ne tregun e punes;
- Mbeshtetje financiare me fonde grant per aktivitetin e organizimit te "Forumit Nderkombetar per Strategjine e Menaxhimit te Integruar per Zhvillim te Qendrueshem Ekonomik te Rajonit te Basenit te Lumit Vjosa (Shqiperi – Greqi)",
- Financimit per permiresimin e teknologjise se informacionit ne fushen e mikrofinances;
- Mbeshtetja financiare per realizimin e marredhenieve publike dhe publiciteti me personat fizike dhe juridike;

- Ngritjen e kapaciteteve per permiresimin e infrastruktures per subjekte private qe operojne ne fushen e bujqesise;
- Financimin per nxitjen dhe promovimin e tradites kombetare per prodhimet autoktone te produkteve shqiptare.

✓ **Ne mbeshtetje te arsimit, sportit dhe kultures**

Gjate vitit 2020, Fondacioni ABC ka mbeshtetur me fonde grant aktivitete me objekt:

- Financimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike.
- Financimin e aktiviteteve dhe konkurseve ne mbeshtetje dhe promovimit te sportit.

## ➢ ARRITJET DHE PERFORMANCA

Aktivitetet e grantdhenies dhe aktivitetet ekonomike te realizuara per periudhen e vitit 2020 jane mbeshtetur ne "Programin e Veprimeve te vitit 2020" te Fondacionit ABC, program i cili eshte bazuar ne faktoret e meposhtem;

- Ne objektivin e qendrueshem institucional te Fondacionit ABC per te fuqizuar ne menyre te kujdesshme aktivitetin e tij nga viti ne vit, bazuar edhe ne eksperiencen e krijuar tashme gjate 11 viteve te aktivitetit te tij (2009-2020);
- Ne kapacitetet aktuale te Fondacionit ABC, per t'ju pergjigjur nevojave reale te komunitetit te biznesit dhe shoqerise civile, ne harmoni me burimet financiare;
- Ne forcimin e komunikimit dhe marrjes se informacionit real nga shoqeria civile dhe strukturat e biznesit, lidhur me prioritetet e tyre sipas fushave te veprimtarive specifike;
- Ne permbushje te iniciativave per perfshirje ne sipermarrje te rendesishme agrobiznesi, ne mbeshtetje dhe partneritet me FondiBESA sh.a.
- Dhenia e ndihmes, kryesisht ne forme grantesh per grupet ne nevoje.

Programi i vitit 2020 ka qene i orientuar ne prioritetet e strategjise se aktivitetit te Fondacionit ABC per;

1. Permiresim te klimes se biznesit ne Shqiperi;
2. Mbeshtetje per shoqerine civile dhe grupet ne nevoje;
3. Mbeshtetje per sektorin e Mikrofinances;
4. Mbeshtjetje per ruajtjen dhe promovimin e trashegimise kulturore;
5. Promovimin dhe mbeshtetjen e brezit te ri me qellim aftesimin profesional, pershtatjen e tyre ne tregun e punes dhe punesimit konkret nepermjet projekteve INTERNSHIP.
6. Nxitjen dhe zhvillimin e agroturizmit, mbeshtetjen financiare te subjekteve tregtare qe kane te bejne me prodhimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqesore, blegtorale dhe ngritjen e industrise agroperpunuese.
7. Ne mbeshtetjen financiare per zhvillimin dhe promovimin e artit, sportit, kultures.

   Keto prioritete jane mbeshtetur nga buxhete te mirebalancuara, duke i dhene perparesi mbeshtetjes per "permiresimin e klimes se biznesit" dhe te statusit te "grupeve ne nevoje".

## ❖ REALIZIMET E PROGRAMEVE GRANT GJATE VITIT 2020;

Te dhenat per realizimet e financimeve me fonde grant, bazuar ne kontratat & marreveshjet grant te kryera gjate periudhes se vitit 2020, ne vijim:

| Perfituesi nga programi I grantdhenies | Projekti | Vlera e Grantit |
|---|---|---|
| Familje ne nevoje | Fushate humanitare ne ndihme te familjeve ne nevoje per shkak te situates se krijuar nga pandemia COVID-19", nepermjet ofrimit te produkteve te ndryshme ushqimore | 185,409 ALL |
| BAI | Permiresim I infrastuktures ne mbeshtetje te zhvillimit te subjekteve tregtare qe kane si veprimtari te tyre prodhimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqesore, blegtorale dhe industrise agroperpunuese | 4,800 Euro |
| Agro & Social Fund sh.p.k | Financimi nga Fondacioni ABC me fonde grant per "Instalimin e software, perdorimin e licences dhe te sherbimeve BankPro Microfinance Institution",(projekt i vitit 2019 ne progres realizimi gjate vitit 2020)+shtese granti 20,000 Euro | 2,482,600 ALL |
| Eduart Dedaj – Person Fizik- per organizimin e eventeve | Financim per realizimin e aktivitetit kulturor dhe artistik "Miss Universe Albania & Kosova 2020", aktivitet i cili u zhvillua ne gjysme finale dhe finale ne datat 17 – 18 Shtator 2020 dhe u transmetua ne televizionet Vizion Plus dhe Klan Kosova. | 4,000 Euro |

| Perfituesi nga programi I grantdhenies | Projekti | Vlera e Grantit |
|---|---|---|
| kulturore dhe artistike | | |
| Te rinj te sapodiplomuar – Projekt nga Fondi Besa sh.a | Mbeshtetje e te rinjve permes projektit INTERNSHIP, me qellim aftesimin profesional dhe pershtatjen e tyre ne tregun e punes". Internshipi u realizua nepermjet mbeshtetjes se stafit te Fondit Besa sh.a. | 657,606 ALL |
| SHOQATA "OLIMPIC JUNIOR KOMBINAT 2018 | Financimi me Fonde Grant nga Fondacioni ABC per "Pjesemarrjen e ekipit te futbollit "Olimpic Tirana" ne kampionatin "Sunday League Tirana"" per blerjen e kostumit sportiv dhe uniformes per 22 lojtare te ekipit | 600 Euro |
| ALBA TECH SYSTEM sh.p.k | Financimi me Fonde Grant nga Fondacioni ABC per "Pjesemarrjen e ekipit te futbollit "ATS" ne kompeticionin sportiv "Liga e Biznesit" per blerjen e uniformave dhe çantave sportive per 25 anetare te ekipit ATS | 3,650 Euro |
| Fondi Besa sh.a | "Realizimin e publicitetit ne median e shkruar dhe vizive per promovimin e aktivitetit te subjekteve qe operojne ne fushen e mikrofinances" | 13,094 Euro |
| Fondi Besa sh.a | "Realizimin e publicitetit ne median televizive per promovimin e aktivitetit te subjekteve qe operojne ne fushen e mikrofinances" | 18,360 Euro |
| Shoqata "Konfederata E Industrive Te Shqiperise" | Financimi me fonde grant nga Fondacioni ABC per aktivitetin e organizimit te "Forumit Nderkombetar per Strategjine e Menaxhimit te Integruar per Zhvillim te Qendrueshem Ekonomik te Rajonit te Basenit te Lumit Vjosa (Shqiperi – Greqi)", forum i cili u organizua ne Permet-Shqiperi ne daten 11 Dhjetor 2020 | 2,000 Euro |
| Individe – prodhues te veres | Financimi nga Fondacioni ABC per "Realizimin e konkursit te prodhuesve te vererave ne vitin 2020", me pjesemarres 12 konkurrente punonjes te Fondit Besa sh.a., - prodhues te veres, konkurs i cili u zhvillua ne date 08 Dhjetor 2020. | 1,942 Euro |
| Granti BE – Transnational Cooperation Programme Interreg Balkan – Mediterranean 2014-2020 | Bashkefinancim Projekti "Ndertimi i bashkesive te dijes per Ndermarrjet mikro dhe te vogla konkurruese " me Akronimin Skills4MSEs, projekt i cili po zbatohet nen Programin e Bashkepunimit Ballkan – Mesdhe 2014-2020, instrumenti IPA II, me nje buxhet te pergjithshem projekti prej € 504,278.00, vlera e kontrates per Fondacionin ABC € 74,640.00 – ne progres... | 74,640.00 € |

## ❖ AKTIVITETI INVESTUES, FINANCIAR DHE EKONOMIK.

Per realizimin e objektivit te grantdhenies, nevojat financiare gjate vitit 2020 jane plotesuar nga te ardhurat prej pasurise se Fondacionit dhe aktivitetit te tij ekonomik.
Fondi I themelimit te Fondacionit ABC eshte krijuar ne vitin 2009 nga kalimi ne pronesi te tij nepermjet dhurimit 100% te pasurise se Fondacionit BESA (dhuruesi) dhe transferimit 100 % te te drejtave te pronesise se investimeve qe Fondacioni BESA kishte ne formen e aksioneve te Fondi BESA sh.a. duke u bere Fondacioni ABC aksioneri kryesor I Fondi Besa sh.a.
Gjithashtu Fondacioni ABC, prej vitit 2014, ne partneritet me shoqerine Fondi Besa sh.a, eshte angazhuar ne krijimin e shoqerise Besa Agro Invest sh.p.k (BAI) – nje ferme bujqesore e standarteve bashkekohore.
Ne celje te vitit ushtrimor 2020, pjesemarrja e Fondacionit ABC ne kapitalin aksioner te Fondi BESA sh.a, ishte **65.624%** dhe ne shoqerine BAI sh.p.k ne masen **91.00%.**

Gjate vitit 2020, me qellim realizimin e te ardhurave nga investimet ne pjesemarje per venien e ketyre te ardhurave ne funksion te veprimtarise se grantdhenies, Fondacioni ABC ka vleresuar te rrise investimin e tij ne pjesemarrjet e mesiperme, dhe ne 31 Dhjetor 2020, Fondacioni ABC eshte pjesemarres ne kapitalin aksioner, perkatesisht ne masen **66.064%** ne kapitalin e Fondi Besa sh.a., dhe **91.81%** ne kapitalin e "Besa Agro Invest" sh.p. k.

Si rezultat i pjesemarrjeve te mesiperme, vlera e investimit te Fondacionit ABC ne tituj pronesie ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese = 2,409,578,382.40 Leke

Per realizimin e te ardhurave me qellim perdorimin e tyre per financime ne mbeshtetje te veprimtarise se tij jofitimprurese, Fondacioni ABC ka lidhur 2 marreveshje huadhenieje me shoqerine aksionere Fondi Besa sh.a., ne vleren totale 1,901,685,558.55 Leke. Gjate vitit 2020 nuk ka ndryshime ne kapitalin e investuar ne keto marreveshje.

## ➤ RAPORTIMI FINANCIAR

| | | | |
|---|---|---|---|
| **FONDACIONI ALBANIAN BESA CAPITAL** | | | |
| **PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR 31 Dhjetor 2020** | | | |
| **AKTIVET** | **Shenime** | **31/12/2020** | **Viti 2019** |
| **AKTIVET** | **4.1** | | |
| Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre | 4.1.1 | 5,889,738 | 52,504,712 |
| Te drejta dhe interesi I arketueshem | 4.1.2 | 42,835,747 | 43,111,009 |
| Kontribute te arketueshme | | | |
| Inventare dhe shpenzime te parapaguara | 4.1.3 | 8,720,108 | 9,314,651 |
| | | | |
| Investime financiare afatagjata | 4.1.4 | 1,901,685,559 | 1,901,685,559 |
| Aktive te kufizuara per investime ne toka, ndertesa dhe paisje | | 0 | 0 |
| | | | |
| Toka, ndertesa dhe paisje | 4.1.5 | 15,911,694 | 16,133,379 |
| Investime te tjera afatgjata | 4.1.6 | 2,409,578,382 | 2,104,077,099 |
| **TOTALI I AKTIVEVE** | | **4,384,621,229** | **4,126,826,409** |
| | | | |
| **DETYRIMET** | **4.2** | | |
| Te pagueshme | 4.2.1 | 3,984,317 | 3,692,074 |
| Deftesa te pagueshme | | | |
| Kontribute te marra ne avance | | - | - |
| | | | |
| **Grante** | | | |
| Premtime te kushtezuara per te dhene | 4.2.2 | 6,284,828 | 8,778,074 |
| Hua afat gjate | | | |
| | | | |
| **TOTALI I DETYRIMEVE** | | **10,269,146** | **12,470,148** |
| | | | |
| **AKTIVET NETO** | 4.3 | | |
| **Te kufizuara** | 4.3.1 | 2,031,092,042 | 2,031,092,042 |
| **a) Toke ose vepra arti te dhuruara per t'u perdorur per qellime specifike me percaktimin qe te ruhen apo te mos shiten** | | | |
| **b) Aktive te dhuruara me qellimin per t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime te perhershme te ardhurash** | | 2,031,092,042 | 2,031,092,042 |
| | | | |
| **Te pakufizuara** | 4.3.2 | **2,343,260,041** | **2,083,264,219** |
| **TOTALI I AKTIVEVE NETO** | | **4,374,352,083** | **4,114,356,261** |

| | PASQYRA E AKTIVITETEVE (PERFORMANCES) | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Pershkrimi i zerit** | **Shenimet** | **31/12/2020** | **2019** |
| | **Ndryshimi nga aktivet neto te pakufizuara:** | **4.4** | | |
| | | | | |
| | **Te ardhurat:** | **4.4.1** | | |
| ▶ | Te ardhura nga tarifat e anetaresimit | | - | - |
| ▶ | Te ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare | | **2,435,279** | - |
| ▶ | Te ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci te tjera te financimit | | - | - |
| ▶ | Te ardhura nga investimet apo dhurimet | i | 335,787,425 | 312,055,344 |
| ▶ | Tarifat per sherbimet | | | |
| ▶ | Te ardhura nga aktivitetet tregtare | | | |
| ▶ | Te ardhura te tjera | ii | *71,100* | *389,830* |
| | **Totali I te ardhurave nga aktivet neto te pakufizuara** | | ***338,293,804*** | ***312,445,174*** |
| | **Aktive neto te cliruara nga kufizimet:** | | | |
| | Realizimi I kufizimeve te programit | | | |
| | Realizimi I kufizimit per blerjen e paisjeve | | | |
| | Perfundimi I kufizimit te afatit | | | |
| | **Totali I aktiveve neto te cliruara nga kufizimet** | | | |
| | **Totali I te ardhurave nga aktivet neto te pakufizuara:** | | ***338,293,804*** | ***312,445,174*** |
| | **Shpenzime per aktivitetet** | i | ***(12,737,616)*** | ***(4,849,521)*** |
| | Aktiviteti Jofitimprures - Grantdhenia | | *(9,494,885)* | *(4,849,521)* |
| | | | *(3,242,731)* | - |
| | | | - | - |
| | **Shpenzime administrimi dhe te tjera te pergjithshme** | ii | ***(65,560,367)*** | ***(68,734,491)*** |
| | **Krijim dhe rritje fondesh** | | | |
| | **Totali I shpenzimeve** | **4.4.2** | ***(78,297,982)*** | ***(73,584,012)*** |
| | **Rritja/renia ne aktivet neto te pakufizuara (A)** | **4.4.3** | ***259,995,822*** | ***238,861,162*** |
| | **Ndryshimi ne aktivet neto te kufizuara:** | | | |
| | **Kontributet** | | | |
| | **Te ardhura nga investimet afatgjata** | | | |
| | **Te ardhura nga investimet afatgjata** | | | |
| | **Fitimi I realizuar dhe I parealizuar nga investimet afatgjata** | | | |
| | **Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor** | | | |
| | **Aktivet neto te cliruara nga kufizimet (me shenje minus)** | | | |
| | **Rritja/renia ne aktivet neto perkohesisht te kufizuara (B)** | | | |
| | **Ndryshimi ne aktivet neto (A+B)** | | ***259,995,822*** | ***238,861,162*** |
| | **Aktive neto ne fillim te vitit** | | ***4,114,356,261*** | ***3,886,666,537*** |
| | **Aktive neto ne fund te vitit** | | ***4,374,352,083*** | ***4,114,356,261*** |

# FONDACIONI ALBANIAN BESA CAPITAL
## Pasqyra e Flukseve te Mjeteve Monetare
## 31 DHJETOR 2020
## Metoda Indirekte

| | | 31/12/2020 | 2019 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVITETET E SHFRYTEZIMIT** | | | |
| **Ndryshimet ne aktivet neto** | | **259,995,822** | **238,861,162** |
| **Rregullimet per perputhjen e ndryshimeve ne aktivet neto me flukset neto nga aktivitetet e shfrytezimit:** | | **4,511,527** | **(5,891,871)** |
| | Amortizimi dhe zhvleresimi | 3,916,985 | **3,011,834** |
| | Humbjet e realizuara dhe te parealizuara ne investime | | |
| | Humbjet nga dalja jashte perdorimit e makinerive pajisjeve | | |
| | Kontributet jo ne para | | |
| | Rritjet/Reniet jo ne para te inventareve | | |
| | Kontributet e kufizuara per investime ne dhurime/ndihma | 594,541 | (8,903,704) |
| **Ndryshimet ne aktivet dhe detyrimet afatshkurtra** | | **(1,925,741)** | **(30,621,377)** |
| | Te tjera te arketueshme | 275,262 | **(40,816,769)** |
| | Shpenzime te parapaguara | 0 | **0** |
| | Bamiresi ne mirebesim te arketueshme | | |
| | Te pagueshme | 292,243 | **1,667,318** |
| | Bamiresi mbi baza vjetore | (2,493,245) | **8,528,074** |
| **Flukse neto nga aktivitete e shfrytezimit** | | **262,581,608** | **202,347,914** |
| **AKTIVITETET INVESTUESE** | | | |
| | Blerje/Shitje investimesh | (305,501,283) | **(259,680,010)** |
| | Blerje/Shitje e Aktiveve afatgjata | (3,695,299) | **(3,493,885)** |
| | Principal I arketuar nga deftesat e arketueshme | | |
| | Te arketuara ne avance nga deftesa te arketueshme | | |
| **Flukse neto nga aktivitetet investuese** | | **(309,196,582)** | **(263,173,895)** |
| **AKTIVITETET FINANCUESE** | | | |
| | Arketime nga kontributet e kufizuara per investime ne dhurime/ndihma | (0) | 76,500,000 |
| | Principal I paguar per deftesat e pagueshme | | |
| **Flukse neto nga aktivitetet financuese** | | **(0)** | **76,500,000** |
| | | | |
| **Rritje/Renie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve te tyre** | | **(46,614,975)** | **15,674,019** |
| | | | |
| **Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre ne fillim te periudhes** | | **52,504,712** | **36,830,691** |
| | | | |
| **Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre ne fund te periudhes** | | **5,889,738** | **52,504,712** |
| | | | |
| **Mjete monetare te paguara gjate periudhes per interesa** | | | |
| **Mjete monetare te paguara gjate periudhes per tatim taksa** | | | |

Enkeleda Stefani

AUDIT SERVICES

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Bordit Drejtues të

**Fondacionit "Albanian Besa Capital"**
**Nipt K92431451E**
Rr. Dritan Hoxha, Laprake,Tiranë

**Opinioni**

Ne kemi audituar Pasqyrat financiare bashkëlidhur të Fondacionit Albanian Besa Capital Tirane të cilat perfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e aktiviteteve (performancës), dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur, në të gjitha aspektet materiale, japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për pozicionin financiar të Fondacionit Albanian Besa Capital më 31 Dhjetor 2020, të performancës financiare dhe flukseve të parasë për ushtrimin që mbyllet në këtë datë,pasqyra të cilat janë përgatitur në përputhje me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse.

**Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqiperi, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

**Informacione të tjera**

Në lidhje me auditimin tonë te pasqyrave financiare, përgjegjesia jonë është te lexojmë informacionet e tjera dhe duke bërë këtë, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër është dukshëm jo konsistent me pasqyrat financiare ose bazuar në njohuritë tona të marra gjatë auditimit, të vlerësojmë nëse ato dukshëm janë paraqitur me anomali materiale. Në qoftë se bazuar ne punën qe ne kemi kryer, ne arrijmë në konkluzion se gjenden anomali materiale në këto informacione, ne kerkojmë ta raportojmë këtë fakt.
Sa më sipër ne nuk kemi konstatime për të raportuar.

**Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të përmiresuara, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Enkeleda Stefani

AUDIT SERVICES

**Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.
Si pjesë e një e auditimi në pajtim me SNA-të, audituesi ushtron gjykimin profesional dhe mban skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.
Në një auditim përgjegjësitë e audituesit janë:

(i) Të identifikojë dhe te vlerësojë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga mashtrimi apo gabimi; të hartojë dhe kryejë procedura auditimi në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve; dhe, të marrë evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin e audituesit. Rreziku moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.
(ii) Të sigurojë njohjen dhe kuptimin per kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm të entitetit. Në rrethanat kur audituesi ka edhe përgjegjësinë për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, audituesi do të heqë frazën ku theksohet se marrja në konsideratë e kontrollit të brendshëm nga audituesi nuk ka si qëllim shprehjen e një opinioni mbi efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm
(iii) Të vlerësojë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve (vlerësimeve) kontabël dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.
(iv)Të arrijë në një konkluzion lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë nga ana e drejtimit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, të vlersojë nëse ekziston një pasiguri materiale lidhur me ngjarje ose rrethana të cilat mund të hedhin një dyshim të madh për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Nëse audituesi arrin në konkluzionin se ekziston një pasiguri materiale, ai është i detyruar të tërheqë vemendjen në raportin e audituesit, lidhur me informacionet shpjeguese përkatëse të dhëna në pasyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojë opinionin. Konkluzionet e audituesit bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri ne datën e raportit të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana të ardhshme mund të bëjnë që entiteti të ndalojë së vijuari veprimtarinë.
(v) Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, të vlerësojë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet mbështetëse në një mënyrë të atillë që arrihet paraqitja e drejtë.

Tirane me, 30 Mars 2021

**Enkeleda Stefani**

**Auditues Ligjor**

Adresa: Rr.Vaso , ND22, H23, AP4. Tirane Albania
Mobile:++355682005013
e-mail: enkeleda.s@fin-es.com

ENKELEDA STEFANI
EKSPERT KONTABEL

## ➢ STRUKTURA, DREJTIMI DHE MBIKQYRJA

Fondacioni “ALBANIAN BESA CAPITAL” eshte person juridik. Ai ka organizimin e vete te brendshem dhe zgjedh organet perfaqesuese te tij.

Fondacioni e ushtron veprimtarine e tij nepermjet organeve te tij drejtuese.

### Organet drejtuese

Organet drejtuese te Fondacionit jane:

- Bordi Drejtues
- Drejtori Ekzekutiv

### Bordi i Fondacionit. Kompetencat

Bordi i Fondacionit perbehet nga nje minimum prej tre dhe nje maksimum prej shtate anetaresh. Bordi ka kompetencat e meposhtme:

1. Eshte organi me i larte drejtues vendimmarres i Fondacionit;
2. Ben ndryshimet ne Statut vetem me miratimin e themeluesit.
3. Harton dhe miraton Rregulloret e Fondacionit, si dhe aktet e tjera te cilat konsiderohen te nevojshme per permbushjen e objektivave dhe qellimeve te Fondacionit;
4. Miraton strategjine, buxhetin dhe planet vjetore te punes;
5. Ne ushtrimin e kompetencave te veta nxjerr norma per rregullimin e veprimtarise, organizimit dhe struktures se Fondacionit;
6. Emeron dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv;
7. Percakton udhezuesit e Pergjithshem te punesimit, si dhe çdo shpenzim qe tejkalon buxhetin e miratuar nga ana e tij;
8. Analizon dhe aprovon raportet e aktivitetit te propozuara nga Drejtori Ekzekutiv;
9. Ka te drejte te krijoje komitete, te caktoje dhe te heqe anetaret e tyre;
10. Mbyll aktivitetin e Fondacionit vetem pasi ka marre miratimin e themeluesit.

Bordi Drejtues I Fondacionit ABC perbehet nga:

| | |
|---|---|
| 1 - Altin Muca | Kryetar I Bordit Drejtues – afati deri me 13/01/2025 |
| 2 - Irma Disha | Anetare - afati deri me 13/01/2025 |
| 3 - Valbona Xhafa | Anetare - afati deri me 13/01/2025 |
| 4 - Kamelia Vojka | Anetare - afati deri me 15/12/2023 |
| 5 - Valbona Greva | Anetare - afati deri me 15/12/2023 |

## Drejtori Ekzekutiv

Statusi i Drejtorit Ekzekutiv percaktohet si me poshte:

a. Eshte perfaqesuesi i Fondacionit perpara organeve te ndryshme shteterore, perpara Gjykates, si dhe perpara te treteve;
b. Emerohet dhe shkarkohet nga Bordi me 2/3 e votave te gjithe anetareve;
c. Mandati i Drejtorit Ekzekutiv do te jete per nje periudhe te pacaktuar;
d. Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit "ALBANIAN BESA CAPITAL" eshte Z. Bajram MUÇAJ.

## Struktura e Burimeve Njerezore

| Nr. | Departamenti | Pozicioni I punes | Nr. Punonjes gjate periudhes |
|---|---|---|---|
| 1 | Zyra e Drejtorit Ekzekutiv | Drejtor Ekzekutiv | 1 |
| 2 | Departamenti I Finances dhe Administrates | Drejtor I Finances | 1 |
| | | Shofer | 2 |
| | | Pastruese | 1 |
| | | Punonjes sherbimi | 1 |
| 3 | Departamenti i Projekteve, Marketingut, Trajnimeve& Marredhenieve me Publikun | Zevendes Drejtor Ekzekutiv & Drejtor I Projekteve | 1 |
| | | Specialiste e Projekteve | 2 |
| | **Total** | | **9** |

## SYNIMET PER TE ARDHMEN

Sikurse deri me tani, qe prej fillimit te funksionimit te tij, Fondacioni ABC, nepermjet grantdhenies, ne permbushje te misionit te tij, synon te jete nje partner I rendesishem ne

- ✓ mbeshtjetjen e shoqerise civile;
- ✓ mbeshtetje te komunitetit te biznesit per nxitjen e sipermarrjes private, zhvillimin, promovimin dhe zgjerimin e aktivitetit te ketyre entiteteve, duke I nxitur ato per iniciativa te sipermarrjes private, nxitjen e punesimit dhe vetepunesimit me qellim zhvillimin ekonomik dhe social ne vend;
- ✓ ne mbeshtetje te grupeve ne nevoje per angazhimin dhe permiresimin e jetes social ekonomike te ketyre grupeve.

Duke njohur zhvillimet dhe shqetesimet aktuale te komunitetit te biznesit, nepermjet iniciativave te tij bashkepunuese Fondacioni ABC do te jete nje partner i rendesishem ne mbeshtetje te permiresimit te klimes se biznesit ne Shqiperi. Per te arritur rezultatet e synuara, per kete qellim do te intensifikohet komunikimi dhe bashkepunimi me institucionet publike, shteterore apo private, te cilat jane te perfshira aktivisht ne jeten e biznesit ne vend.

Ne objektiv te veprimtarise se tij ne vazhdim, Fondacioni ABC do te kete:

- Dhenien e granteve per mbeshtetjen e: grupeve ne nevoje; te shoqerise civile; ne rritjen e kapaciteteve te biznesit dhe grupeve te interesit nepermjet realizimit te studimeve, trajnimeve dhe seminareve per ato subjekte qe operojne ne fushen e biznesit te vogel dhe te mesem ne Shqiperi, mbeshtjetjen e ideve novatore ne te berit biznes, etj.

- Mbeshtetjen per kryerjen e kualifikimeve dhe asistenca teknike per personat juridike dhe fizike per orientimin drejt praktikave te mire - administrimit te biznesit, realizim te politikave rekomanduese si dhe te marredhenieve publike dhe publiciteti ne ndihme te veprimtarise se personave fizike e juridike.

- Mbeshtetje financiare per permiresim te infrastruktures dhe teknologjise, asistence teknike dhe konsulence per institucionet e mikrofinances.

- Zhvillim aktiviteti ekonomik per realizimin e te ardhurave ne mbeshtetje te qellimit per te cilin ai eshte krijuar dhe realizimit te objektivave te tij ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi, Statutin dhe Aktin e Themelimit.

**Drejtori Ekzekutiv**

**Prof. Asoc. Dr. Bajram MUÇAJ**

FONDACIONI A.B.C. ALBANIAN BESA CAPITAL